

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 14 TETOR 2021

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

E kërkova fjalën sot për të folur rreth një çështjeje, e cila gjatë kësaj jave ka qenë kryefjalë për të gjitha auditoret dhe mjediset universitare, vaksinimin e studentëve. Një nga sakrificat më të mëdha, që u detyruam të bëjmë për shkak të pandemisë së Covid-19, ka qenë pikërisht mësimi online nëpër universitete dhe kjo jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë globin. Studentët jo vetëm që vuajtën pasojat shëndetësore të kësaj krize, sepse shumë prej tyre edhe vetë u infektuan, por u detyruan të marrin online leksionet, seminarët, si dhe socializimin me njëri-tjetrin, duke vuajtur kështu pasoja shëndetësore, sociale dhe psikologjike, madje duke pasur edhe pasiguri më vonë pas diplomimit për tregun e punës. E për këtë arsye, për të kthyer normalitetin në universitete, ashtu sikurse edhe në sektorët e tjerë të shoqërisë, në shumë shtete është marrë vendimi për vaksinimin e detyrueshëm të pedagogëve, të studentëve dhe të të gjitha stafeve universitare, që do të thotë ndryshe se të gjithë pedagogët dhe studentët mund të hyjnë në auditoret e universiteteve vetëm me kartën e vaksinimit apo me testin e PCR-së. Por ama nuk duhet të harrojmë që pandemia sot, në mbarë botën, ka sjellë edhe një pasojë tjetër për të cilën nuk flitet shumë, ka rritur akoma më shumë pabarazinë, sidomos për shtresat e margjinalizuara, konkretisht, në këtë rast për studentët e margjinalizuar që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta apo nga komunitete të caktuara dhe që aksesin për mësimin online e kanë pasur shumë më të vështirë sesa studentët e tjerë. Prandaj universitetet sot, përveçse kanë detyrimin si shumë institucione të tjera që të ruajnë shëndetin e studentëve dhe të pedagogëve, duke garantuar shëndetin dhe të ardhmen e tyre, kanë edhe detyrimin etik dhe moral që të nxisin më shumë barazi nëpërmjet edukimit. Por kjo nuk mund të arrihet nëse ne nuk luftojmë rrezikun dhe frikën nga pandemia e Covid-19 në mjediset universitare. Mënyra më e mirë dhe më e shpejtë për ta bërë këtë është vetëm vaksinimi masiv i studentëve, i pedagogëve dhe i të gjitha stafeve, siç jua thashë pak më lart. Ndërkohë, në Shqipëri, dua të falënderoj të gjithë studentët që i janë bashkuar kësaj fushate dhe që po na ndihmojnë të rikthejmë normalitetin edhe në universitete, ashtu sikurse edhe në institucionet dhe fushat e tjera.

Pas pak ditësh fillon viti i ri akademik dhe të gjithë presim me padurim rikthimin në auditore dhe rigjallërimin e jetës universitare. Por ama ne, të dashur studentë, duam që ju të gjithë të ktheheni në auditore pa rrezikuar jetën tuaj, jetën e familjarëve tuaj, jetën e pedagogëve dhe të komunitetit në tërësi. Për këtë arsye këtë javë e kemi shpallur si “Java e vaksinimit masiv të studentëve”, për t’ju dhënë edhe një mundësi që t’i afroheni akoma më shumë këtij procesi. Dua të falënderoj veçanërisht Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, e cila u tregua menjëherë e gatshme për të sjellë dhe për të vënë në dispozicion të gjithë personelin e vaksinimit në auditoret e universiteteve, si dhe vetë universitetet, që u treguan të gatshëm dhe patën një bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me personelin e vaksinimit, duke vënë në dispozicion të gjitha auditoret dhe mjediset e tyre për ta realizuar me sukses këtë proces! Vetë studentët i inkurajoj fort që t’i bashkohen sa më shumë këtij procesi dhe ta shfrytëzojnë këtë mundësi, që së bashku të garantojmë një fillim sa më të mbarë, por

edhe një vit akademik të suksesshëm. Testi PCR natyrisht është një opsion, por unë do të këmbëngulja fort për vaksinimin, sepse vaksinimi është mënyra më e mirë, edhe duke u bazuar në të dhënat e shkencës dhe në praktikën më të mira të vendeve të tjera, qoftë të vendeve të rajonit, qoftë edhe të vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Europian. Vaksinimi është i rëndësishëm për të gjithë ne, por akoma më i rëndësishëm është për studentët që do t'u rikthehen auditoreve, ku do të takohen e do të jetojnë me shokët dhe shoqet e tyre, do të hyjnë nëpër rezidenca universitare, të cilat vazhdimisht vitin e kaluar kanë qenë rrezik. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse mësimi ka qenë online. Dua t'ju përsëris edhe një herë: auditoret universitare, kampuset dhe mbi të gjitha rezidencat universitare mund të ktheheshin në vatra të mëdha të shpërndarjes së infeksionit. Këtë nuk e them unë, por e thonë ekspertët e shëndetësisë jo vetëm këtu në Shqipëri, por në të gjitha vendet e tjera në të gjithë globin. Ka edhe një arsye tjetër, madje, e cila është e rëndësishme, që secili prej nesh, duke përfshirë edhe studentët, të vaksinohet, sepse ky proces është detyrim edhe ndaj shtresave vulnerabël, pra ndaj atyre që janë më të pambrojtur. Ne kemi edhe detyrimin të mbrojmë edhe ata që nuk vaksinohen dot për një arsye apo për një tjetër, sipas udhëzimeve të mjekut. Atëherë, ne që mund të vaksinohemi e kemi detyrim dyfish për të mbrojtur veten tonë, familjet tona, komunitetin, por për t'i mbrojtur edhe ata që janë më shumë të rrezikuar. Po e mbyll fjalën time duke ju bërë thirrje: "Vetëm vaksinimi masiv ndalon përhapjen e infeksionit, ju mbron ju, të dashur studentë, familjet tuaja, pedagogët dhe gjithë komunitetin në tërësi". Faleminderit!